

Sofjan Jaupaj (LLM në Drejtësi) – Sofjan Jaupaj u diplomua për Drejtësi në vitin 2013 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës ku ka qenë anëtar i rrjetit të studentëve ekselentë të këtij Universiteti dhe ndoqi studimet LL.M. për të Drejtën e Pronësisë Intelektuale në Itali, Zvicër (përfitues i bursës evropiane të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale). Në 10 vitet e fundit ai ka mbajtur pozicione të ndryshme në sektorin publik në Shqipëri si Drejtor i Kabinetit i Kryenegociatorit për Integrimin në BE të Shqipërisë, Drejtor i Integritit dhe Koordinator i Lartë për normat ligjore prioritare të BE-së pranë Kryeministrit dhe Ministrit të Kulturës dhe aktualisht në 3 vitet e fundit ka qenë i emëruar Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Nga viti 2021 ai është Autoriteti Kombëtar për Fondin e Gjellbër të Klimës dhe Fondin Global të Mjedisit. Ai ka qenë profesor i jashtëm në disa lëndë ligjore gjatë 2019-2021. Z. Jaupaj është trajnuar nga Akademia Diplomatike e Vjenës dhe Kolegji i Evropës Brugges për çështjet evropiane dhe diplomacinë ekonomike si dhe nga “Harvard Law School” në SHBA për pronësinë intelektuale me specialitet të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të. Ai është një alumni i Akademisë Politike të Këshillit të Evropës. Zotëron në nivel të shkëlqyer gjuhën angleze dhe italiane.